# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5908
E shtunë, 19 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## Rinumërimet vonojnë shpalljen e rezultatit final të zgjedhjeve

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", AFRIM HOTI FAQE 4-5



# Vendimi i BE-së, sinjal se rruga drejt BE-së nuk është e lehtë

## - Moshapja e negociatave nuk duhet t'i dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se nuk është i padrejtë vendimi i Bashkimit Evropian për moshapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai ka thënë se ky vendim është sinjal se rruga drejt BE-së nuk është e lehtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se anëtarësimi në BE nuk është çështje e deklarimit, por e plotësimit të kritereve dhe bërjes së reformave që janë shumë të nevojshme për secilin shtet. Ai ka thënë se atë që e ka bërë Franca ka mundur ta bëjë secili vend por, sipas tij, Franca ka mbetur zëri më i fuqishëm për moszgjerimin e BE-së. Megjithatë, Hoti ka thënë se ky vendim nuk duhet t'i dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor për vazhdimin e reformave dhe rrugën drejt Bashkimit Evropian

## LV-ja dhe LDK-ja pajtohen për parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje

FAQE 3




Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë pajtuar të premten për parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Pas takimit të grupeve punuese, zyrtari i lartë i LV-së, Glauk Konjufca, ka thënë se në këtë takim është biseduar për temat kryesore politike dhe për reformat kyçe sektoriale të cilat e presin qeverinë e re. Sipas tij, këto dy subjekte politike nuk kanë folur për ndarje postesh, duke shtuar se as LV-ja e as LDK-ja nuk i kanë vendosur kushte njëra-tjetrës



## Në Gjinekologji hiqet tumori nëntëkilogramësh

FAQE 3

## OPINION



### SHQIPTARËT DHE EVROPA, AFËR DHE LARG F. 6

Prof. Lisen BASHKURTI

## AKTUALE



### FSK-ja, E DYTA NË GARËN NDËRKOMBËTARE 'CAMBRIAN PATROL 19' F. 6

## EKONOMI

### TATIMET DHE TAKSAT DOGANORE DIKTOJNË PROJEKSIONET PËR BUXHETIN F. 9

### MALLRAT EVROPIANE GODITEN NGA TARIFA TË REJA TË SHBA-së F. 9

## KULTURË

### SA HERË I KUJTOJ XHEVË DHE FEHMI LLADROVCIN MË MBUSHEN SYTË ME LOT F. 16-17

## SPORT

### FFK-ja: S'KA BILETA NË SHITJE PËR NDESHJEN ME ÇEKINË F. 16-17


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



## Osmani përmbyll vizitën në ShBA me takimin me Madeline Albright

PRISHTINË, 18 TETOR - Kandidatja për kryeministre nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka bërë me dije se ka përmbyllur vizitën e saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me një takim me ish-sekretaren e Shtetit, Madeline Albright. Osmani e ka cilësuar të përzemërt takimin me Albright, e cila ka thënë se ka frymëzuar shumë gra në mbarë botën. "Nder i veçantë ta përfundoj vizitën time në ShBA me një takim shumë të përzemërt me ish-sekretaren e Shtetit, Madeline Albright, e cila, përveçse u shndërrua në shpëtimtaren tonë në kohët më të rënda, po ashtu ka frymëzuar shumë gra anekënd globit që mos të dorëzohen kurrë para sfidave që dalin përpara", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".

Liderët e Bashkimit Evropian pa pajtim lidhur me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

# Rama: Ne kryem detyrat tona, përgjegjësia është e BE-së

Pas një debati të gjatë, liderët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian kanë dështuar që të arrijnë pajtim për vendimin lidhur me nisjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një konferencë me gazetarë ka thënë se Shqipëria ka kryer detyrat e veta dhe përgjegjësia është e BE-së

TIRANË, 18 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën për media ka folur për 'Jo'-në që Evropa dha për negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. "Janë bërë përpjekjet maksimale që të marrim atë që na takon. E kemi merituar dhe këtë e thonë edhe një pjesë e madhe e kryeministrave të BE-së. Dua t'ju them se kam marrë shumë mesazhe nga një pjesë e kryeministrave të pranishëm në takim. Kam komunikuar edhe me Macronin dhe, faktikisht, nëse duam të shikojmë drejt në sy të vërtetën, është ajo që kam thënë prej kohësh, se procesi po shkonte drejt një përplasje qasjesh mes Francës dhe Gjermanisë. Gjermania bëri një lëvizje për kompromis, duke i vendosur një 'Por', 'Po'-së dhe nuk ka pasur nga Macroni asnjë hapje. Franca nuk pranon të vazhdohet me të njëjtin proces. Ajo kërkon një reformim të brendshëm të BE-së. Kjo që ka ndodhur si rezultat i mosarritjes së konsensusit mes vendeve anëtare, është e tepërt kur i shtohen bishta kësaj çështje", ka thënë Rama. "Kemi marrë një refuzim, por nuk kemi marrë asgjë më shumë se kaq. Rruga jonë është e njëjta", ka thënë ai.

Rama ka shtuar se ata të cilët janë jashtë nesh, ata të cilët përfaqësojnë BE-në, e thonë pa ekuivok se për mosarritjen e vendimit të djeshëm përgjegjësia është e BE-së. "Është e papranueshme që këtu mes vete shtrohet diskutimi sikur ajo e djeshmja vjen si pasojë e mospërmbushjes së detyrave. Ne i kemi bërë ato. Po ta shikoni vendimin e qershorit thonë se do të merrej në tetor, dhe sa herë kam folur, kam vendosur pikëpyetje se e kam parashikuar që do të kishte



Yves Herman (Reuters)

mospërputhje që do të shkonte në konflikt. Ne kemi marrë një refuzim për t'u marrë në konsideratë. Përgjegjësia është e brendshme e BE-së. Është absurde të mendosh se ky vendim vjen si pasojë e mospërmbushjes së detyrave. Nuk është aspak kështu. Ne kemi përmbushur detyrat tona. Ka disa qasje në BE. Kryeministri italian tha se ky është gabim i madh. Franca është ndër themelueset e BE-së dhe do rregulla të reja në shtëpinë e vet", është shprehur kryeministri Rama. "Të vazhdojmë tani përpara se Shqipëria evropiane është e vetmja alternativë dhe testament i patjetërsueshëm për gjeneratat e tjera", ka thënë Rama.

## Refuzimi i Tiranës dhe Shkupit nga BE-ja konsiderohet "gabim i madh"

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, pranoi se "disa vende anëtare" të bllokut nuk kanë qenë të gatshme ta lejojnë fillimin e negociatave të anëtarësimit në BE me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. "Unë personalisht mendoj se ky ka qenë një gabim i madh", tha Tusk në një konferencë për media, pasi Këshilli Evropian, natën e kaluar, nuk ka arritur pajtim për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shkupin dhe Tiranën. Tusk theksoi se këto dy vende nuk duhen fajësuar për vendimin e tillë, pasi të dyja ato janë të gatshme për nisjen e negociatave tani. Ai kërkoi nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria që të mos heqin dorë nga ambiciet e tyre dhe premtoi se ato do të bëhen një ditë anëtare të plota të Bashkimit Evropian. "Vërtet turpërohem për këtë (vendim)", ka thënë Tusk.

Edhe presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, tha se është "thellësisht i zhgënjyer" nga mungesa e unitetit për zgjerimin dhe shtoi se rezultati i debatit të së enjtes është një "gabim historik". Refuzimi për ta pranuar përparimin e dëshmuar do të ketë pasoja negative, përfshirë rrezikun e destabilizimit të Ballkanit Perëndimor, me ndikim të plotë në BE, tha komisionari i Zgjerimit, Johannes Hahn. Ai theksoi se BE-ja duhet të sqarojë se sa serioz është angazhimi i saj për integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor.

## Basha: Vendimin për negociatat e prisnim, u paralajmërua nga Bundestagu

TIRANË, 18 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tha në një konferencë me gazetarë, se vendimi negativ për hapjen e negociatave pritej, pavarësisht se nuk ishte ai që kishte shpresuar. "Nuk është ajo që kemi dëshiruar dhe shpresuar, por do të ishte një gënjeshtër e madhe ndaj shqiptarëve po t'i thoshim se nuk e prisnim. Që prej vendimit të Bundestagun për vendosjen e 9 kushteve Shqipërisë dhe hapjen e negociatave vetëm pas plotësimit të këtyre 9 kushteve, ishte e qartë që Këshilli Evropian nuk do të mund të merrte një vendim më pozitiv se ai", tha Basha. "Dokumenti gjerman është udhërrëfyesi për hapjen e negociatave. Ne donim një rezultat ndryshe sot, por nuk prisnim më mirë sesa vendimi i Bundestagut për të marrë një 'Po' pa kushte, siç mund ta kishte marrë Maqedonia. Kushtet ishin 5, u bënë 7, u bënë 9, sepse Shqipëria po bën hapa prapa. Dy kushtet e reja të Bundestagut kanë të bëjnë me procedimin penal të personave për blerjen e votave dhe zgjedhje sipas një kodi të miratuar me konsensusin e forcave politike. Shkaku është se kryeministri aktual vuri fatin e tij, të kriminelëve dhe oligarkëve të tij mbi fatin evropian të Shqipërisë. Ka një përpjekje për ta shitur atë të sotmen si një përplasje mes vendeve të BE-së dhe jo si një keqqeverisje. Në këtë gjendje nuk ta hapë askush derën e negociatave. Këtë ta thotë edhe



qytetari më i zakonshëm në fshatin më të largët, sepse vendi nuk po qeveriset, por po sundohet", tha Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Takohen grupet punuese të Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së)

# LV-ja dhe LDK-ja pajtohen për parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje




**Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë pajtuar të premten për parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Pas takimit të grupeve punuese, zyrtari i lartë i LV-së, Glauk Konjufca, ka thënë se është biseduar për temat kryesore politike dhe për reformat kyçe sektoriale të cilat e presin qeverinë e re. Sipas tij, këto dy subjekte politike nuk kanë folur për ndarje postesh, duke shtuar se as LV-ja dhe as LDK-ja nuk i kanë vendosur njëra-tjetrës kushte**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 TETOR - Grupet punuese të Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) janë takuar të premten për të diskutuar lidhur me marrëveshjen e koalicionit qeverisës. Grupet punuese janë pajtuar lidhur me përmbajtjen dhe parimet e marrëveshjes për bashkëqeverisje. "Në takim u shqyrtuan temat kryesore politike dhe reformat kyçe sektoriale të cilat e presin qeverinë e re", është thënë në komunikatën e përbashkët për medie të këtyre partive.

Hollësi për diskutimet nuk ka dhënë as zyrtari i lartë i LV-së, Glauk Konjufca, i cili ka folur për media pas takimit që është mbajtur në zyrat e LDK-së. "Kemi folur për temat më të rëndësishme të cilat e presin qeverinë e ardhshme dhe për reformat e thella sektoriale të cilat duhet t'i marrë qeverisja e ardhshme e LV-së dhe e LDK-së. Nuk mund të flas në hollësi, sepse ne mendojmë se gjëja më e mirë e cila do të mund t'i kontribuonte kësaj atmosfere shumë të mirë të bashkëpunimit me të cilën filluan takimet tona, do të ishte një lloj mirëbesimi që e kemi për trajtimin e temave", ka thënë ai.

Në vija të trasha, Konjufca ka treguar se çka duhet të bëjë qeveria e re. "Ne kemi nevojë shumë për reforma të thella në drejtësi, arsim, shëndetësi dhe në administratë. Pra, është folur më shumë për reformat sektoriale për të cilat ne kemi nevojë. Nuk është folur për ministri, as për ndarje të resorëve të ndryshëm", është shprehur Konjufca.

Në mënyrë kategorike Konjufca ka mohuar që këto dy subjekte politike i kanë vendosur kushte njëra-tjetrës. Sipas zyrtarit të LV-së, takimi ka qenë shumë miqësor, ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm. "As ne nuk kemi kushte për LDK-në, as ajo nuk ka kushte për ne. Ky nuk ka qenë takim i kushteve, as përballje mes kushteve. Ka qenë takim i mirë, me ç'rast janë folur temat më të rëndësishme që e presin qeverinë e ardhshme menjëherë në ditën e parë të fillimit të punës dhe reformat sektoriale të cilat ne kemi nevojë t'i bëjmë", ka deklaruar Konjufca.

Përveç Konjufcës, në këtë takim LV-ja ka qenë e përfaqësuar edhe nga nënkryetari Besnik Bislimi dhe Albulena Haxhiu. Kurse LDK-ja ka qenë e përfaqësuar nga Avdullah Hoti dhe Lumir Abdixhiku. Po ashtu, palët janë pajtuar për shtimin e takimeve, duke treguar se takimi i radhës do të mbahet të mërkurën, në të cilin do t'i konkretizojnë diskutimet që kanë bërë të premten.

Takimet e grupeve punuese të dy partive janë mundësuar tek pas takimit të liderit të LV-së, Albin Kurtit, me liderin e LDK-së, Isa Mustafa, që ka ndodhur javën e kaluar. Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së të zgjedhjeve të 6 tetorit, LV-ja ka dalë subjekti i parë politik, kurse LDK-ja subjekti i dytë.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka deklaruar se grupet punuese mund të punojnë për përafrimin e objektivave qeverisëse, ndërkaq pasi të përfundojë krejtësisht procesi i numërimit të të gjitha votave dhe të dihet subjekti i parë, do të përpiqen të gjejnë zgjidhje për mënyrën e participimit në qeverinë e re.

## Thaçi takohet me vajzat që do ta përfaqësojnë Kosovën në garën e robotikës në Dubai



PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim ekipin që do ta përfaqësojë vendin në garën ndërkombëtare të robotikës "First Global Challenge", ekip i cili është përgatitur dhe trajnuar në ambientet inovative të UBT-së. Me këtë rast, presidenti Thaçi u ka dëshiruar sukses studentëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë garë në mesin e rreth 200 vendeve nga bota, e që sivjet mbahet në Dubai, më datë 24-27 tetor. "Sot e takova grupin e studenteve inovatore që do ta përfaqësojnë Kosovën në Dubai në garën ndërkombëtare të robotikës në mesin e 170 shteteve. Kosova ka të rinj dhe të reja me talent në të gjitha fushat e shkencës, në sport dhe muzikë. Iu dëshiroj sukses Albanës, Eltës dhe Elitës!", ka theksuar presidenti Thaçi.

Ekipi përfaqësues i Kosovës tash e disa muaj është përgatitur në laboratorët inovativë të mekatronikës në UBT, teksa punën e ka zhvilluar nën mbikëqyrjen e stafit akademik të UBT-së. Bashkërisht ata kanë ndërtuar robotin inovativ që do të jetë pjesë e garës në FIRST Global Challenge 2019. Sfida e këtij viti përqendrohet në efektet e ndotjes së oqeaneve dhe ndikimin e saj negativ në jetën detare. Ekipet konkurruese nga kombe të ndryshme duhet t'i pastrojnë ndotësit nga oqeani duke përdorur robotë që kanë përbërës mekanikë, elektrikë dhe softuerë.

Flet për "Epokën e re", Afrim Hoti

# Vendimi i BE-së, sinjal se rruga



## - Moshapja e negociatave nuk duhet t'i dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se nuk është i padrejtë vendimi i Bashkimit Evropian për moshapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ai ka thënë se ky vendim është sinjal se rruga drejt BE-së nuk është e lehtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoti ka deklaruar se anëtarësimi në BE nuk është çështje e deklarimit, por e plotësimit të kritereve dhe bërjes së reformave që janë shumë të nevojshme për secilin shtet. Ai ka thënë se atë që e ka bërë Franca ka mundur ta bëjë secili vend por, sipas tij, Franca ka mbetur zëri më i fuqishëm për moszgjerimin e BE-së. Megjithatë, Hoti ka thënë se ky vendim nuk duhet t'i dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor për vazhdimin e reformave dhe rrugën drejt Bashkimit Evropian

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 TETOR - "Epoka e re": *Z. Hoti, liderët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk janë pajtuar për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut pavarësisht se një gjë e tillë u është premtuar më parë. Si e komentoni këtë vendim?*

**Hoti:** Nuk është vendim politik, por vendim strategjik. Ky më tepër shpërfaq qëndrimin e Francës tashmë të deklaruar publikisht, se BE-ja nuk duhet të shkojë drejt zgjerimit gjeografik. Pra, para shkuarjes nga zgjerimi gjeografik duhet të shkojë kah thellimi, respektivisht konsolidimi i sistemit të brendshëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Dhe kjo, sipas të gjitha gjasave, ka qenë mbizotëruese në qëndrimin e Francës për t'i mbetur besnik këtij koncepti që, para se të fillohet me anëtarësim të vendeve të reja, në radhë të parë për Ballkanin Perëndimor duhet të thellohet bashkëpunimi i shteteve tashmë anëtare të BE-së dhe ky qëndrim mbizotëroi edhe në takimin e Këshillit të Ministrave.

"Epoka e re": *Një vendim i tillë, a dëshmon joseriozitetin e BE-së për integrimin e Ballkanit Perëndimor?*

**Hoti:** Jo, nuk mendoj se është joserioze, por është ballafaqim i koncepteve në BE dhe kjo praktikë e ka përcjellë Bashkimin Evropian që nga themelimi e deri më sot jo vetëm për çështje të zgjerimit, por edhe për çështje të tjera sepse vazhdimisht kemi pasur dy blloqe. Franca e ka parala-

# drejt BE-së nuk është e lehtë



jmëruar kohë më parë se BE-ja nuk duhet të ngutet me anëtarësime të reja, por duhet të thellohet bashkëpunimi në mes të vendeve anëtare. Ky duhet të jetë sinjal shumë i fuqishëm për shtetet e tjera që janë kandidate, por edhe për kandidatet potenciale se rruga drejt BE-së nuk është çështje e deklarimit, por e plotësimit të kritereve dhe bërjes së reformave që janë shumë të nevojshme për secilin shtet.

**"Epoka e re":** *Kjo qasje e BE-së do t'i dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor?*
**Hoti:** Nëse vendet e Ballkanit Perëndimor kanë menduar se rruga drejt BE-së është e lehtë atëherë janë gabuar shumë dhe ky vendim duhet të jetë sinjal i qartë se rruga drejt BE-së nuk është çështje forme, por përmbajtje. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duhet të dekurajohen sepse plotësimi i kushteve dhe reformat nuk duhet të bëhen sa për ta kënaqur BE-në dhe sa për t'u paraqitur para tyre se jemi vërtet BE por, më shumë se kaq, është interesi i vendeve që aspirojnë të jenë pjesë e BE-së që t'i rregullojnë sistemet e tyre të brendshme juridike dhe politike. Në këtë drejtim nuk mendoj se duhet të dekurajohen vendet që synojnë BE-në, përkundrazi duhet të punojnë edhe më tepër dhe kurdo që t'u jepet një shans për t'i hapur negociatat dhe për t'u bërë pjesë e BE-së, ato t'i kenë të kryera detyrat.

**"Epoka e re":** *Si duhet ta lexojnë këtë vendim të BE-së, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut?*
**Hoti:** Duhet ta lexojnë si sinjal shumë serioz. Duhet ta lexojnë si një garë që duhet ta vazhdojnë plotësimin edhe të standardeve të tjera sepse edhe sikur të jepej drita jeshile kjo nuk nënkupton se këto vende do të bëheshin pjesë e BE-së, por praktikisht ato vetëm sa do ta fillonin lojën dhe garën e gjatë për t'u anëtarësuar në BE. Absolutisht nuk duhet të këtë dekurajim dhe qasje për ta trajtuar këtë vendim si joserioz, përkundrazi duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre për t'u bërë pjesë e BE-së në momentumin e mundshëm.

**"Epoka e re":** *Por në vazhdimësi është thënë se këtyre vendeve do t'u hapen negociatat për anëtarësim sikurse që është thënë dikur për liberalizimin e vizave, por që në asnjërën prej rastev,e BE-ja nuk e mbajti fjalën.*
**Hoti:** BE-ja nuk është çështje e prezantimit të një zëri të bashkuar, por është zëri i 28 vendeve anëtare. Në secilën fazë të zhvillimit të BE-së kemi pasur ndeshje të koncepteve ose formim të bllokut pro zgjerimit ose kundër zgjerimit. Madje blloqe të tilla ka edhe në kuadër të vet shteteve anëtare të BE-së. Në këtë drejtim nuk mund të flasim për çështje të mosmbajtjes së fjalës, por cilësim të bllokut që është pro thellimit dhe jo pro zgjerimit në këtë momentum. Fitorja e këtij blloku nuk do të thotë se vendet kandidate nuk kanë vend në BE. Ato duhet ta vazhdojnë rrugën e tyre dhe t'i plotësojnë kriteret sepse plotësimi i kritereve nuk duhet të bëhet për BE-në, por për vetë vendet.

**"Epoka e re":** *Eurodeputetja Tanja Fajon, duke e komentuar këtë vendim, ka thënë se BE-ja ka mbetur peng e Francës. Çfarë do të thotë për ju kjo deklaratë?*
**Hoti:** Procedura e vendimmarrjes në BE në momentin e hapjes së negociatave për anëtarësim nënkupton po të thënë qartë dhe me zë nga secili vend anëtar. Pozita e Francës është e barabartë në kuptimin formal me secilin vend anëtar të BE-së. Franca historikisht ka pasur dhe ka pozicion dominues në BE dhe ky pozicion do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Atë që e ka bërë Franca ka mund ta bëjë secili shtet anëtar sepse ministrat e këtyre vendeve duhet të thonë po ose jo të qartë dhe me zë. Përveç Francës janë edhe një numër i vendeve të tjera të cilat në rastin e Maqedonisë Veriore dhe Shqipërisë kanë qenë më të buta por, megjithatë, skepticizmi i BE-së për t'u zgjeruar vazhdon dhe Franca ka mbetur zëri më i fuqishëm. Franca mbetet vend përcaktues.

**"Epoka e re":** *Moshapja e negociatave, a e rrezikon vazhdimin e reformave dhe ndikimet e tjera në Ballkanin Perëndimor?*
**Hoti:** Një gjë e tillë do të ishte fatale apo do të ishte saktësisht ajo çfarë nuk duhet të ndodhë. Sepse reformat dhe veprimet e tjera si sundimi i ligjit dhe kërkesat e tjera që vijnë nga BE-ja nuk janë çështje e interesit të BE-së dhe të Francës, por janë çështje e interesit të shteteve që e synojnë BE-në. Në këtë dritë mendoj se këto shtete duhet t'i vazhdojnë reformat e tyre sepse ky vendim duhet të jetë inkurajim për të ecur tutje.

**"Epoka e re":** *Ju nuk e shihni si vendim të padrejtë moshapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut?*
**Hoti:** Jo, absolutisht nuk është i padrejtë, por mund të duket dhe të tingëllojë i padrejtë për faktin se ne presim dhe themi se jemi më evropianë se evropianët, por çështja e BE-së nuk është çështje e formës, por e përmbajtjes. Ky vendim është sinjal edhe për vendet e tjera të cilat synojnë të jenë pjesë e BE-së, se ato duhet t'i plotësojnë kriteret. Pra, këtë që e ka bërë Franca ka mundur ta bëjë secili vend, por Franca është më e fortë dhe nuk iu ka trembur syri, prandaj e ka marrë këtë vendim. Edhe për Kosovën ky është një sinjal i fuqishëm se rruga kah BE-ja nënkupton plotësim të kritereve.

# Latifi: Dështimi për hapje të negociatave, grusht dërrmues për aspiratat evropiane

Prishtinë, 18 tetor - Profesori i filozofisë, Blerim Latifi, ka thënë të premten se dështimi i Bashkimit Evropian për t'i hapur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut është një grusht dërrmues për aspiratat evropiane të popujve të këtyre dy shteteve. Sipas tij, tash e tutje forcat proevropiane, forcat demokratike e liberale në këto shtete do ta kenë përherë e më vështirë luftën e tyre kundër ndikimit agresiv të ideologjive autoritariste lindore.

Latifi ka thënë se nëse ShBA-ja nuk rikthehet për ta mbajtur Ballkanin brenda sferës perëndimore, atëherë skenarët e errët kanë shumë gjasë të marrin jetë këndej pari. "Dështimi i Bashkimit Evropian, për t'i hapur negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, është një grusht dërrmues për aspiratat evropiane të popujve të këtyre dy shteteve. Tash e tutje forcat proevropiane, forcat demokratike e liberale në këto shtete, do ta kenë përherë e më vështirë luftën e tyre kundër ndikimit agresiv të ideologjive autoritariste lindore. 'Vija e Teodosit', e cila, prej shekujsh, e ka ndarë Ballkanin midis Perëndimit dhe Lindjes, është duke u rishfaqur frikshëm. Nëse ShBA-ja nuk rikthehet për ta mbajtur Ballkanin brenda sferës perëndimore, atëherë skenarët e errët kanë shumë gjasë të marrin jetë këndej pari. Në atë rast dy gjëra do të jenë të sigurta: shoqëritë tona do të vuajnë edhe më shumë dhe në fund Bashkimi Evropian do të detyrohet t'i paguajë faturat e këtyre vuajtjeve!", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".



# Haradinaj dhe drejtoresha e MCC-së nënshkruajnë amendamentimin e marrëveshjes CDF

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim një delegacion të nivelit të lartë nga MCC, kryesuar nga Caroline T. Nguyen, drejtoreshë menaxhuese e MCC-së për Evropë, Azi, Pacifik dhe Amerikë Latine. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, bashkë me delegacionin e MCC-së kanë nënshkruar amendamentimin e marrëveshjes CDF (Compact Development Fund), që do t'i mbështesë aktivitetet e profizibilitetit të projekteve të dorëzuara nga Qeveria e Kosovës në MCC në korrik të këtij viti.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, e ka njoftuar drejtoreshën Nguyen për zhvillimet e fundit në vend, duke thënë se Kosova ka arritur të ndërtojë demokraci të qëndrueshme, duke forcuar institucionet e vendit dhe në këtë rrugëtim do ta vazhdojë angazhimin që të avancojë edhe në partneritete të kësaj natyre, që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve tanë dhe në fuqizimin ekonomik të vendit. "Kontributi i ShBA-së është i pazëvendësueshëm dhe programi Millenium Challange Corporation (MCC) është dëshmi e vazhdimësisë së këtij partneriteti afatgjatë mes dy vendeve", ka deklaruar kryeministri në detyrë Haradinaj, duke shtuar se populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për ndihmën që ShBA-ja ka dhënë për Kosovën, veçmas tani me programet e MCC-së që mbështet përpjekjet e qeverisë për reforma në fusha të ndryshme.

Më tej, kryeministri në detyrë, Haradinaj, vlerësoi se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është një tjetër hap i madh që çon në zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të shumë projekteve të rëndësishme në vend dhe Kosova është e vendosur që t'i zbatojë obligimet e saj karshi këtij bashkëpunimi.




Ndërkaq Caroline T. Nguyen, drejtoreshë menaxhuese e MCC-së për Evropë, Azi, Pacifik dhe Amerikë Latine, ka falënderuar kryeministrin në detyrë, Haradinaj, për pritjen e sotme dhe ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka qenë partnere në këtë rrugëtim duke mirëpritur thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit.

# FSK-ja, e dyta në garën ndërkombëtare 'Cambrian Patrol 19'



PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka marrë vendin e dytë në garën prestigjioze ushtarake "Cambrian Patrol 19". "Në njërën prej garave ushtarake më prestigjioze në botë 'Cambrian Patrol 19', ekipi i Forcës i Sigurisë të Kosovës arriti që ta rrëmbejë medaljen e argjendtë, duke u radhitur i dyti në këtë garë. Gara patrulluese filloi më 16 tetor 2019 dhe zgjati 48 orë, pa ndërprerë. Në të morën pjesë gjithsej 132 ekipe, prej të cilave 34 ishin nga shtetet e ndryshme", është thënë në njoftimin FSK-së.

Kjo është hera e tretë që Forca e Sigurisë merr pjesë në këtë ushtrim përkrah ushtrive nga Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina dhe Greqia. "Kjo është hera e tretë që FSK-ja po merr pjesë në garën ndërkombëtare ushtarake 'Cambrian Patrol' e cila organizohet nga Brigada e Këmbësorisë 160 e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar. Përveç Republikës së Kosovës, në garën 'Cambrian Patrol 19' në Mbretërinë e Bashkuar morën pjesë edhe ekipet e forcave të armatosura të vendeve të rajonit si nga Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina dhe Greqia.

Gara 'Cambrian Patrol 19' është një aktivitet shumë sfidues dhe prestigjioz ushtarak që teston të gjitha aftësitë themelore ushtarake të ushtarit të sotëm, duke rritur aftësinë e udhëheqjes dhe nivelin e qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë", është thënë në këtë njoftim.

# Në Gjinekologji hiqet tumori nëntëkilogramësh

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës një ekip mjekësor ka kryer një operacion të ndërlikuar te një grua, duke i hequr një masë tumorale në mitër që peshonte tetë kilogramë. "Ndërhyrja kirurgjike është bërë me thikë ultrasonike dhe ka përfunduar me sukses brenda një intervali kohor prej tri orë e gjysmë. Pacientja është nën mbikëqyrjen e mjekëve, me një gjendje shëndetësore të mirë dhe pritet të lirohet shumë shpejt", është thënë në njoftimin e QKUK-së. Sipas këtij njoftimi, ekipet mjekësore në këtë klinikë kanë kryer edhe më herët operacione të rralla dhe të komplikuara, kryesisht të natyrës së njëjtë, me sukses të plotë, pa pasur nevojë që pacientët të shkojnë jashtë vendit për trajtim.



# Rinumërimet vonojnë shpalljen e rezultatit final të zgjedhjeve

Prishtinë, 18 tetor - Përmbyllja e procesit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të mbajtura më 6 tetor në Kosovë, që nënkupton shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe certifikimin e tij, sipas zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mund të zgjasë afërsisht edhe dy javë të tjera. Ndërkaq sipas Institutit Demokratik të Kosovës, i cili në kuadër të koalicionit të organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim ka qenë i përfshirë në vëzhgimin e gjithë procesit, deri te shpallja e rezultatit final mund të zgjasë edhe një muaj. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë thënë se procesi i votave me kusht dhe atyre nga diaspora ka ndikuar në vonesë, ndërkohë që po shtohen kërkesat edhe për rinumërimin e votave në më shumë se 500 vendvotime.

Kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Enis Halimi, ka shpjeguar për "Radion Evropa e Lirë" se KQZ-ja është duke punuar që procesi në radhë të parë të përfundojë mirë dhe më pas të dilet edhe me rezultate përfundimtare. "Pikërisht ky dimension [votat me kusht dhe ato nga diaspora] e bëjnë më të komplikuar si proces. Këto dimensione kanë ndikimin e vet edhe në dinamikën e shpalljes së rezultateve përfundimtare. Keni parasysh që ne do të kujdesemi që, përveç shpejtësisë, ta shuaj,ë, si të themi, kureshtjen e opinionit publikut, edhe për integritetin e procesit zgjedhor, përkatësisht për saktësinë gjatë procesit të rinumërimit", ka thënë Halimi. Sipas tij, koha më optimale për publikimin e rezultateve do të jetë periudha dyjavore pas ditës së enjte. "Përpilimi i rezultateve është një proces relativisht i paparashikuar për shkak se në proces mund të përfshihen edhe aktorë të tjerë dhe jo vetëm Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe puna e tij. Pra, edhe aktorë të tjerë në kuptimin e ankesave që mund t'i kenë partitë politike, kandidatët e caktuar, pastaj edhe organet të cilat vendosin administrativisht për drejtësi në procesin zgjedhor. Afërsisht nga dinamika e trajtimit të këtyre ankesave dhe numri i tyre përcaktohet edhe koha e shpalljes së rezultateve. Besoj se afërisht për dhjetë ditë, maksimumi dy javë, KQZ-ja do t'i shpallë rezultatet përfundimtare", ka shpjeguar Halimi.



Por, në Institutin Demokratik të Kosovës kanë deklaruar se duke pasur për bazë trendët në të cilët është duke u zhvilluar i tërë procesi dhe dinamika e numërimit dhe rinumërimit të votave, nuk mund të përfundojë para 30 ditëve.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit pritet që si rezultat ta prodhojnë konstituimin e përbërjes së re të Kuvendit dhe formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse, prej tyre 20 ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përkatësisht 10 për komunitetin serb dhe po kaq për komunitetet tjera joshumicë.

Neni 66 i Kushtetutës së Kosovës e parasheh mënyrën e konstituimit të Kuvendit. Aty përcaktohet se Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë ditëve nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. Në bazë të Kushtetutës, kandidati për kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e legjislativit. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave (61 e më shumë) të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Të dielën, më 6 tetor, në Kosovë u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Bazuar në raportimet nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, procesi kaloi qetë dhe ishte në harmoni me standardet demokratike.

# Avni Dehari thotë se mosdorëzimi i raportit është vrasja e dytë për Astritin

Prishtinë, 18 tetor - Prokuroria Themelore e Prizrenit nuk ua ka dhënë prindërve të Astrit Deharit raportin përfundimtar të ekspertizës për vdekjen e Astrit Deharit që është realizuar nga Instituti Zviceran. Prindërit e Astrit Deharit, Avni dhe Xhemile Dehari, së bashku me bashkëshorten e të ndjerit, Artën dhe avokatin e tyre, Tomë Gashi, kanë mbajtur të premten një konferencë për media.

Avni Dehari ka treguar se i ka shkruar një e-mail kryeprokurorit të Prizrenit, Admir Shalës, që ta caktojë një termin që familja ta pranojë raportin origjinal të ekspertizës për rastin e vdekjes së Astrit Deharit. Por, sipas tij, nuk ka marrë një përgjigje.

Babai i të ndjerit, Astrit Dehari, ka thënë se për familjen kjo "është vrasja e dytë e Astritit". "Sikur të na kishin ftuar si familje kur ka ardhur raporti dhe sikur ta hapnim së bashku me ta raportin dhe të na dorëzonin një kopje në origjinal, më pas le ta përkthejnë. Ne si familje nuk kemi nevojë për përkthim, por nëse duhet si procedurë, le ta përkthejnë. Nuk duan ta bëjnë transparent procesin, duan t'i fshehin faktet dhe kjo për ne si familje është vrasje e dytë për Astritin. Vrasja e parë ka ndodhur më 5 nëntor 2016, vrasja e dytë po ndodh tash", ka thënë Avni Dehari.



## Rinumërohen 83 vendvotime nga 530 sa janë parapar nga KQZ-ja

Prishtinë, 18 tetor - Janë rinumëruar 83 vendvotime prej 530 vendvotimeve për të cilat ka marrë vendim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lajmin e ka bërë me dije Valmir Elezi, zëdhënës i KQZ-së. Këto rezultate janë siguruar në orën 16:00 të premten nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve. Para dy ditëve KQZ-ja ka mbajtur mbledhjen në të cilën është marrë vendimi për rinumërimin e 530 vendvotimeve për shkak të parregullsive me rezultate. Vendimi i KQZ-së për rinumërim ka shtyrë edhe për disa ditë numërimin e 24 mijë votave me kusht dhe dy mijë votave të personave me nevoja të veçanta.

# TATIMET DHE TAKSAT DOGANORE DIKTOJNË PROJEKSIONET PËR BUXHETIN

**Prishtinë, 18 tetor** - Të hyrat nga tatimet dhe taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qëndrueshmëria financiare e një shteti, që është burim kryesor i mbushjes edhe të buxhetit të Kosovës. Bazuar në projeksionet aktuale, parashihet që buxheti i Kosovës për vitin 2020 të jetë 2.4 miliardë euro. Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e taksave, tatimeve dhe detyrimeve të ndryshme financiare janë Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës. Këto dy institucione, sipas zyrtarëve të tyre, edhe gjatë këtij viti kanë treguar performancë të mirë për mbledhjen e të hyrave për arkën e shtetit. Ata thonë se i kanë përmbushur projeksionet e Qeverisë së Kosovës për këtë vit. Nga 2.3 miliardë euro sa është buxheti i këtij viti, nga zyrtarët e qeverisë konsiderohet të jetë i realizueshëm, i qëndrueshëm dhe që ruan stabilitetin fiskal.
Parashikimet e qeverisë, tashmë në largim, për Doganën e Kosovës janë që deri në fund të vitit të arrijë të grumbullojë 1.2 miliard euro. Drejtori i këtij institucioni, Bahri Berisha, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se deri më tani janë mbledhur 900 milionë euro. Ndërkaq, deri në fund të vitit Berisha thotë se do të përmbushet projeksioni i parashikuar nga Qeveria e Kosovës. "Projeksioni është duke vazhduar mirë, duke marrë parasysh edhe faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në performancen e Doganës, sepse Dogana mbledh të hyra bazuar në import, aq sa ka vëllim të tregtisë dhe aq sa ka rritje ekonomike. Por, normal ndikim në të hyra mund të kenë edhe politikat fiskale që i kemi në fuqi. Nëse flasim në aspektin nominal, kemi rreth 60 milionë euro vetëm për prodhuesit që janë liruar nga të gjitha taksat, që ka pasur efekt drejtpërdrejt në taksat e Doganës", ka thënë Berisha.
Në të hyrat e Doganës thuhet se nuk vërehet ndonjë efekt i zbatimit të taksës 100 për qind për importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, të cilën Qeveria e Kosovës e ka vendosur në nëntorin e vitit 2018. "Të dhënat tona tregojnë se importi vetëm është zhvendosur drejt vendeve të tjera. Dhe, në bazë të këtij vëllimi, ne nuk mund të dimë saktësisht se ku është rritur apo ku është zvogëluar, sepse nëse ka ardhur një produkt në të kaluarën nga Serbia, tashmë mund të vijë nga Maqedonia, Shqipëria apo Sllovenia. Kjo mund të dallojë edhe në çmime, por mund të ketë efekt negativ edhe pozitiv", thekson Berisha.
Ai thotë se aktualisht Kosova importon më së shumti nga Gjermania, Turqia, Kina, Shqipëria, Italia, Maqedonia e Veriut, Greqia, Sllovenia, Polonia, Bullgaria e kështu me radhë. "Këto janë shtetet në top-listën e 10 vendeve nga të cilat Kosova importon më së shumti", ka shtuar ai.
Për vitin 2020, Dogana e Kosovës, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2020-2022, parashihet të grumbullojë rreth 1.3 miliard euro. Ndërkohë, Administrata Tatimore e Kosovës, thuhet se ka tejkaluar objektivat e planifikuara.
Valentina Bytyçi-Sefa, zëdhënëse në këtë administratë, thotë për Radion Evropa e Lirë se nga muaji janar deri në shtator të këtij viti kjo agjenci ka grumbulluar 372 milionë euro.
Projeksioni i ATK-së për këtë vit, thotë Bytyçi-Sefa, është mbledhja e 516 milionë eurove apo 16 për qind më shumë se plani i vitit të kaluar. "Administrata është duke punuar maksimalisht në luftimin dhe parandalimin e ekonomisë joformale, meqë me uljen e informalitetit do të kemi rritje të të hyrave dhe, njëkohësisht, krijim të barazisë në treg", ka bërë me dije Bytyçi-Sefa.
Buxheti i Kosovës për vitin 2020, sipas Kornizës Afatmesme, parashihet të jetë rreth 2.4 miliardë euro apo një milion euro më shumë sesa buxheti i këtij viti. Miratimi i buxhetit të vitit 2020 pritet t'i mbetet Qeverisë së re të Kosovës e cila do të formohet si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit.



AFP

## Mallrat evropiane goditen nga tarifa të reja të ShBA-së

**Uashington, 18 tetor** - Shumë prodhime nga vendet e Bashkimit Evropian do të bëhen më të shtrenjta për blerësit në Shtetet e Bashkuara pasi që ShBA-ja vendosi të premten tarifa ndaj mallrave të BE-së në vlerë prej 7.5 miliardë dollarësh. Disa lloje të djathit, verës, uiskit dhe vajit të ullirit do të preken nga tarifa e re prej 25 përqindësh. Bashkimi Evropian tha se nuk do të ketë zgjedhje tjetër përveçse të përgjigjet me tarifa të ngjashme.
BE-ja në vitin e kaluar ka vendosur tarifa ndaj disa mallrave amerikane, përfshirë motorët "Harley Davidson", pasi Shtëpia e Bardhë ka vënë taksë mbi aluminin dhe çelikun e BE-së. Ka shqetësime se ShBA-ja mund të vendosë tarifa edhe mbi makinat evropiane nga mesi i nëntorit.
Në një raport të publikuar në muajin qershor, Bashkimi Evropian ka thënë se vitin e kaluar është përballur me 425 barriera tregtare nga 59 vende të ndryshme. "Proteksionizmi është qartazi në rritje", ka thënë komisionarja për Tregti e BE-së, Cecilia Malmstrom.
Administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, është në luftë të ngjashme tregtare edhe me Kinën, të cilën, po ashtu, e fajëson për politika të padrejta të tregtisë.

# Guvernatori Mehmeti me përfaqësuesit e FMN-së diskuton për zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë

**Prishtinë, 18 tetor (ER)** - Në kuadër të takimeve vjetore të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar që po mbahen në Uashington, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, është takuar me zëvendësdrejtorin menaxhues të FMN-së, Tao Zhang, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë, me theks të veçantë për qëndrueshmërinë dhe zhvillimet në sektorin financiar.
Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka falënderuar Fondin Monetar Ndërkombëtar për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës dhe BQK-së në veçanti, njëkohësisht ka falënderuar Zhangun për gatishmërinë e FMN-së që të kontribuojë në Konferencën e 20-vjetorit të themelimit të BQK-së që do të mbahet në nëntor të këtij viti. Guvernatori Mehmeti është takuar edhe me drejtorin e Departamentit Evropian të FMN-së, Poul Thomsen, me të cilin kanë diskutuar lidhur me zhvillimet e fundit makroekonomike, për zhvillimet në sistemin financiar, si dhe për sfidat dhe objektivat strategjike dhe zhvillimore, përfshirë edhe bashkëpunimin e Kosovës me FMN-në. Po ashtu, guvernatori Mehmeti ka zhvilluar takim edhe me drejtorin e Konstituencës tonë në FMN, Raci Kaya.
Gjithashtu, është zhvilluar takim edhe me Paul Methieu nga Departamenti i Politikave Monetare dhe Tregjeve të Kapitalit të FMN-së, ku temë diskutimi ka qenë vlerësimi i FMN-së në kuadër të programit: "Shqyrtimi i Stabilitetit të Sistemit Financiar" (anglisht: Financial System Stability Review-FSSR) dhe rrjedhimisht ofrimi i Asistencës Teknike për BQK-në, përderisa në takimin me përfaqësuesin e Bankës Botërore, Mario Guadamillas, janë diskutuar asistencat teknike për sistemin e pagesave dhe hendekun financiar, si dhe projekte të tjera zhvillimore të BQK-së.



# Më 23 tetor hapet edicioni i 19 i Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve

**Prishtinë, 18 tetor (ER)** - Panairi Ndërkombëtar i Agrobiznesit dhe Ushqimit AGROKOS do të mbahet nga 23-25 tetor në ambientin e sallës 1 Tetori në Prishtinë. Në këtë panair do të marrin pjesë shumë kompani të agrobiznesit vendor nga Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Austria.
Në AGROKOS konsumatori kosovar ka mundësinë t'i njohë dhe t'i shijojë prodhimet bujqësore dhe blegtorale vendëse të cilat gjithnjë e më shumë po bëhen të pranishme në tregun tonë dhe në atë të huaj. AGROKOS po shihet si mundësia më e mirë për bizneset vendore që t'i promovojnë produktet e tyre si dhe është transformuar në pikëtakim të domosdoshëm të bizneseve ndërkombëtare që dëshirojnë të shtrihen në tregjet e Ballkanit. Gjithashtu, pjesë e këtij panairi janë edhe kompani që merren me paketimin, ambalazhimin e produkteve bujqësore, si dhe institucionet shtetërore e financiare që me politikat e tyre ndikojnë në zhvillimin e sektorit të agrobiznesit.




## Kina shënon rritjen më të zbehtë ekonomike në 27 vjet

**Pekini, 18 tetor** - Ekonomia kineze, në çerekun e tretë të vitit, ka shënuar rritjen më të zbehtë në 27 vjetët e fundit, teksa ky shtet po përballet me luftën tregtare me Shtetet e Bashkuara. Të dhënat tregojnë se brutoprodhimi i brendshëm ka arritur në 6 për qind në periudhën korrik-shtator, në krahasim me 6.2 për qind sa ka qenë në çerekun e dytë. Ndonëse një shifër e tillë do të përbënte sukses të madh në disa kombe të industrializuara perëndimore, për Kinën ky është lajm negativ.
Zëdhënësi i Zyrës Kombëtare të Statistikave, Mao Shengyong, ka thënë se Kina është "përballur me rritje të rreziqeve dhe sfidave si në shtëpi, po ashtu edhe jashtë saj". Kina është përfshirë në një betejë tregtare me Shtetet e Bashkuara, duke iu kundërpërgjigjur secilit veprim me të njëjtën monedhë. Shumë ekspertë besojnë se kjo luftë tregtare mund të ndikojë në aktivitetin ekonomik global.



# Në Gjilan nis shënimi i Javës së Shkopit të Bardhë

GJILAN, 18 TETOR (ER) - Në Gjilan ka nisur shënimi i Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkopi të Bardhë. Kryetari i kësaj komune, Lutfi Haziri, gjatë hapjes së kësaj jave ka deklaruar se është i nderuar që po shënojnë Javën e Shkopit të Bardhë për komunitetin dhe për të gjithë për mundësi të barabarta. "Ne duhet të vazhdojmë të bashkëpunojmë dhe të koordinohemi për të gjitha llojet e aktiviteteve në mënyrë që të integrohen të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë. Zoti nuk na ka falë të barabartë, por na i ka dhënë mundësitë e barabarta. Gjilani është zgjedhur komunë për zbatim të programit të UNICEF-it për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Ne do të punojmë për integrimin e fëmijëve në shkolla nëpërmjet ndihmës që ofron sektori i arsimit dhe mirëqenies sociale në mënyrë që të integrohen që në fëmijërinë e hershme", ka thënë Haziri.

Ndërsa kryetari i Shoqatës së të Verbërve në Gjilan, Bajram Spahiu, e ka falënderuar kryetarin Haziri për bashkëpunimin që kanë pasur që prej themelimit të kësaj shoqate, ndërsa ka pohuar se do t'i vazhdojnë aktivitetet e tjera në kuadër të shënimit të Javës së Shkopit të Bardhë.

Kombet e Bashkuara në vitin 1963 kanë shpallur vendimin që nga 15 e deri më 23 tetor të jetë Java Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë.



# Funksionalizohet E-Kiosku në Deçan



DEÇAN, 18 TETOR (ER) - Në Komunën e Deçanit është funksionalizuar E-Kiosku, i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve 24 orë në ditë. Me këtë rast, kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, është qytetari i parë i cili është pajisur me certifikatën e lindjes në E-Kioskun e vendosur në hyrje të objektit të Komunës së Deçanit, i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve 24/7.

Ramosaj ka thënë se ka falënderuar drejtorin e Administratës Komunale, Jashar Dobraj, për realizimin e këtij projekti i cili është në interes të qytetarëve të Komunës së Deçanit. "Duhet ta falënderoj drejtorin e Administratës Komunale, Jashar Dobraj, për përkushtim e tij për realizimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm për qytetarët. Ne si institucion komunal vazhdimisht jemi duke bërë përpjekje që qytetarëve t'u krijojmë kushte më të mira dhe lehtësim të procedurave. Një ndër premtimet tona është edhe vendosja e E-Kioskut", ka thënë Ramosaj.

Në E-Kioskun i cili tashmë është funksionalizuar qytetarët mund të pajisen me ekstraktin e lindjes, certifikatën e lindjes, certifikatën martesore, certifikatën e vendbanimit, deklaratën e bashkësisë familjare dhe certifikatën e shtetësisë.

# Lushtaku inspekton disa projekte në fshatrat e Skenderajt

SKENDERAJ 18 TETOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka inspektuar punimet në shkollën e fshatit Qubrel dhe segmentet e rrugëve në fshatrat Tërrnac dhe Kuqicë. Gjatë inspektimit të këtyre punimeve Lushtaku ka qenë i shoqëruar nga drejtoresha e Urbanizmit, Sanije Ahmeti, inxhinierë dhe profesionistë. Me këtë rast, ata janë njoftuar me dinamikën e punimeve që janë duke u kryer. Banorët e këtyre fshatrave janë shprehur të kënaqur me investimet që po ndodhin në përmirësimin e infrastrukturës në këtë pjesë.



# Vazhdon rregullimi i rrugëve bujqësore në Viti

VITI, 18 TETOR (ER) - Realizimi i projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, e posaçërisht atyre bujqësore, është duke vazhduar në Komunën e Vitisë. Në realizim e sipër është një rrugë bujqësore në fshatin Beguncë, e cila lidh fshatin Sllatinë e Poshtme me fshatin Gërmovë. Për t'i parë nga afër punimet që po zhvillohen në këto dy rrugë, kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka dalë në terren, ku ka takuar banorët e këtyre zonave të cilët e kanë falënderuar atë për përkushtimin që t'u ofrohen shërbime sa më të mira, gjegjësisht qasje në tokat e tyre bujqësore përmes këtyre rrugëve.



# Diskutohet për thjeshtësimin e procedurave administrative në Komunën e Prizrenit

PRIZREN, 18 TETOR (ER) - Në vazhdën e takimeve të organizuara në kuadër të projektit "Analiza e procedurave administrative", i cili ka për qëllim reformimin e shërbimeve administrative në Komunën e Prizrenit, të premten është mbajtur takimi i radhës me përfaqësuesit e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), e cila është anëtare e grupit të Bankës Botërore (BB). Gjatë këtij takimi është diskutuar për procedurat administrative të cilat mund të thjeshtësohen, me ç'rast drejtorët e drejtorive të Komunës së Prizrenit kanë dhënë rekomandimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me raportin e përgatitur nga përfaqësuesit e IFC-së. Me anë të këtij projekti synohet të bëhet thjeshtësimi i procedurave administrative, duke përfshirë eliminimin e procedurave të panevojshme, uljen e kostos së procedurave administrative për bizneset dhe qytetarët, evitimin e kërkesave për dokumentacione të cilat veçse janë në sistem, si dhe rritjen e transparencës rregullatore duke publikuar të gjitha procedurat me informata të nevojshme në faqen zyrtare të komunës.



# Shqiptarët dhe Evropa, afër dhe larg



Prof. Lisen BASHKURTI

Ajo që po ndodh këto ditë është për të qeshur dhe për të qarë. Shqiptarët po shqyejnë sytë plot ankth drejt Evropës, duke pritur prej saj hapjen e negociatave e për të nisur rrugën e gjatë të anëtarësimit në BE, ndërsa kjo e fundit luhatet në qëndrimin ndaj tyre, duke i vrarë padrejtësisht ëndrrën një populli të tërë. Evropa dhe shqiptarët, qeveritë dhe qeverisjet midis tyre, sa afër dhe sa larg!

Në këtë çast të vështirë ne, shqiptarët, lypset të mbushemi me mend. Ëndrrën tonë, Evropën, ta ndërtojmë para së gjithash brenda vetes sonë si qytetarë e qeveritarë. Kur ta kuptojmë këtë, atëherë nuk do të përzvaltemi nëpër zyrat e Brukselit, apo të kryeqyteteve të Evropës, por eurokratët e saj dhe liderët e shteteve individuale do të vijnë në Shqipëri.

Ne shqiptarët nuk lypset as të trishtohemi dhe as të turpërohemi, por ta kthejmë pak kokën prapa në histori. Shqipëria pa Evropën ka jetuar mbi 500 vjet, ndonëse e vendosur në oborrin e saj. Shqipëria kësisoj mbeti e vogël, e varfër dhe e abandonuar. Evropa pa Shqipërinë është e paplotësuar gjeografikisht, historikisht, kulturalisht dhe startegjikisht. Evropa kësisoj krijoi një vrimë të zezë në zemër të saj. Shqipëria është porta detare Euro-Mesdhetare dhe Euro-Aziatike e Kontinentit, por akoma e pambyllur, në mos e shqyer dhe tejet e rrezikuar.

Ne shqiptarët lypset ta fiksojmë mirë se nëse jemi kështu siç jemi, kemi fajet tona, por për këtë ka përgjegjësi edhe Evropa. Nëse jemi kaq sa jemi, sepse kemi bërë gabimet tona, por kjo ka ndodhur edhe sepse Evropa ka bërë të sajën. Nëse përballemi me këto sfida të mëdha, kjo po ngjet sepse historia na ka lënë shumë plagë të hapura, por edhe sepse Evropa nuk ka kontribuar gjithnjë pozitivisht ndaj nesh. Nëse rropatemi për t'u evropianizuar, herë me suksese e herë me dështime, edhe Evropa mban përgjegjësi për këtë, sepse nuk na ka ndihmuar sa dhe siç duhet, sikundër fqinjët tanë, por më shumë me retorikë dhe asistencë burokratike.

Ne shqiptarët duhet ta dimë mirë se nuk ka një Evropë. Ka më shumë se një. Ndoshta edhe shumë më tepër. Një pjesë ka qenë pranë nesh, në të mirë dhe në të keq. Një pjesë ka qenë kaherë kundër ndesh. Ndoshta e tillë do të mbetet edhe për disa kohë. Mundet edhe përherë. Të jemi të përgatitur për këtë sfidë.

Shqiptarët nevojitet ta dinë mirë, njëherë e përgjithmonë, se nuk ka një komb evropian. Nuk ekziston një Evropë e bashkuar dhe unike, as politikisht, as kulturalisht. Po, ka një Evropë të kombeve të lirë. Po, a jemi ne, shqiptarët, komb i lirë? Jo, nuk kemi qenë dhe nuk jemi. Po, vallë, a mund të shkojmë në familjen e kombeve të lirë, si një komb i copëtuar?! Mendoj se jo.

Të gjithë, shqiptarët, para së gjithash, duhet të jemi të vendosur për t'u bërë komb i lirë, pra i bashkuar, e kështu të bisedojmë me Evropën si të barabartë mes të barabartëve. Dhe, e meritojmë këtë. Po, po, e meritojmë plotësisht. Por bashkimi është popullor dhe jo vetëm politik, është real dhe joretorik, është konkret dhe jopropagandistik, është proces dhe jo një akt, është përfitues dhe jo mashtrues, është demokratik dhe dhunues.

Shqiptarët janë kontributorë të mëdhenj në Evropë. Kemi më shumë se 500 vjet që ne shqiptarët, Evropës i ruajmë nderin, historinë, kulturën, besimin e fenë me gjak shqiptarësh. Kemi më shumë se 60 vjet që e kemi paguar me varfërinë tonë të skajshme çlirimin e Evropës, Mesdheut e Ballkanit nga agresiviteti i bazave ushtarako-detare e, ndoshta, edhe bërthamore, të "Sovjetskit Sajuz" e të makinerisë së tij ushtarake, Traktatit të Vrashavës.

Në vitet e demokracisë, ne, shqiptarët, për afro 30 vjet, i kemi dhuruar Evropës lulen e rinisë albe, të shëndetshme, të pastër dhe shumë të ditur për ta përtërirë plakurishten e rrudhur të saj, duke lënë kështu kombin tonë pa rini dhe familjet shqiptare pa fëmijë. Këto kontribute të paçmuara shqiptarëve nuk i janë shpërblyer asnjëherë nga Evropa, së paku deri tani.

Është koha që Evropa të matet një mijë herë kur të bisedojë me shqiptarët. Krenaria u përket shqiptarëve për nga historia. Përgjegjësia bie edhe mbi supet e Evropës për nga aktualiteti. Prandaj, si shqiptarë, të mos përzvaltemi përpara zyrave të Brukselit, apo kancelarive shtetërore, por të jemi shumë kryelartë, sepse në themelet e kalasë së kulturës e prosperitetit të sotëm evropian qëndron edhe gjaku i shqiptarëve.

Është zor të kuptohet e mendohet se si do të ishte Evropa pa veprën monumentale të Gjergj Kastriotit. Por, ndërsa heroin e shqiptarëve, Skënderbeun, e monumentalizojnë në çdo kryeqytet evropian, pasuesit e tij të vyer, i nëpërkëmbin si të jenë azilantë të syrgjynosur prej viseve larg Evropës.

Është zor të merret me mend se si do të ishte krishtërimi evropian pa vendin e rolin e Papë Domeniko Xhvani Albanit, që reformoi kishën, e hapi dhe e shtriu nëpër botë, zhvilloi politikën dhe ndriçoi diplomacinë 300 vjet më parë. Papën shqiptarë e nderojnë kudo në Evropë, por bijtë e bijat e tij të shenjtë disa vende evropiane po i lënë pas dyerve, si të jenë mëkatarët më të mëdhenj të kontinentit plak.

Është zor të imagjinohet sa satan do të ishte qytetërimi evropian pa shenjtoren Nënë Tereza, shpirti i së cilës është shpërndarë anembanë botës me moton… "Nga misioni jam krishtere, nga gjaku jam shqiptare"… Evropa dhe mbarë bota i falen shenjtores shqiptare, në një kohë kur bartësve të shpirtit të saj, shqiptarëve i vënë përballë murin e pakalueshëm të albanofobive.

Shqiptarë, Evropa e sotme, e fshirë nga kujtesa historike ose e mbytur në pellgun e fobive, na ka lënë ne, shqiptarëve, bijtë e Gjergj Kastriotit dhe dishepujt e Shën Terezës, të mënjanuar padrejtësisht. Shqiptarët e Kosovës, të mbyllur në geton e izolimit, pa lëvizje të lirë. Shqiptarët e Shqipërisë, të braktisur në mes të rrugës së integrimit.

Me fjalë të tjera, Evropa po i lë shqiptarët paqësorë mbrapa gjakatarëve të luftërave ballkanike. Në kohën tonë, Evropa, më saktë disa pjesë të saj, midis kurbanit e katilit ballkanik, po prioritizojnë këtë të dytin. Midis proeuropinazmit të pashembullt shqiptar dhe luhatësve euroaziatikë po mbështesin euroskeptikët ballkanikë. Midis harmonisë e tolerancës ndërfetare të shqiptarëve dhe fanatizmit, intolerancës dhe radikalizmit ruso-ortodoks dhe islamo-fashist në këtë pjesë të botës, po u hapin udhë këtyre të fundit. Midis shqiptarëve që shohin lindjen e diellit nga Perëndimi dhe atyre që edhe perëndimin e diellit e shohin nga Lindja, Evropa po preferon të dytët. E, së fundi, Evropa kaotike, në rastin e shqiptarëve, nuk po bën dot as atë, që është më e shenjta vlerë në demokraci - dallimin midis popullit dhe qeverisë, midis orientimit qytetar dhe drejtimit politik, midis agjendës qytetare dhe agjendës politike, midis ëndrrave dhe dëshirave mbarëpopullore e njerëzore dhe zhgënjimeve dhe pakënaqësive të prodhuara nga drejtuesit e tyre.

Evropa po harron se është lidhja, marrëdhënia dhe dashuria ndërmjet popujve të Evropës që e bëri dhe po e mban gjallë Bashkimin Evropian dhe jo thjesht eurokratët e Brukselit dhe qeveritë kryeqytetare të kontinentit. Evropa po injoron përvojën e saj, se është demokracia, vlerat e liritë njerëzore dhe qytetare që mbrojnë paqen në kontinent dhe jo thjesht traktatet në letër apo marrëdhëniet ndërqeveritare. Evropës nuk po i kujtohet mësimi historik se kur popujt duhen me njëri-tjetrin, qeveritë nuk i prishin dot marrëdhëniet ndërmjet tyre. Sikundër, kur popujt urrehen ndërmjet tyre, nuk ka qeveri nacionale apo organizatë ndërkombëtare që i pajton ato. Janë popujt që shtrojnë rrugët për politikat dhe qeveritë, dhe jo e kundërta.

E pra, Evropa si e tërë dhe shtetet evropiane veç e veç lypset të mos e harrojnë se populli shqiptar është më paqësori i Ballkanit dhe jo krijuesi i "Fuqisë së Barotit". Shqiptarët janë bartës më të mirë të harmonisë e tolerancës dhe jo të fanatizmit dhe radikalizmit. Shqiptarët bien e ngrysen me sy vetëm nga Perëndimi dhe jo syshqyer midis Lindjes dhe Perëndimit. Shqiptarët janë shembull i patriotizmit të vyer dhe jo i nacionalizmit të urryer. Shqiptarët kanë nxjerrë heronj të lakmuar dhe jo të harruar, kanë nxjerrë shenjtorë të pavdekshëm dhe jo djaj të maskuar. Shqiptarët kanë një agjendë qytetare të vetme dhe të pandryshueshme - Shqipërinë Evropiane.

Ne, shqiptarët, kemi një faj, dhe këtë nuk duhet ta harrojmë, nuk po e përputhim dot aspiratën popullore evropiane me qeveritë dhe qeverisjet tona, që nuk janë kurdoherë të tilla. Nuk po bashkojmë agjendën tonë qytetare me atë politike. Nuk po i bëjmë dot qeveritë dhe qeverisjet që të rendin pas nesh dhe jo të rendim ne pas tyre.

Ne, shqiptarët, por edhe qeveritë dhe qeverisjet tona lypset të kuptojnë dhe të respektojnë njëherë e mirë, që qeveritë dhe qeverisjet duhet të ecin nga shkojnë njerëzit dhe jo njerëzit të shkojnë mbas qeverive dhe qeverisjeve. Njerëzit shqiptarë shkojnë drejt Perëndimit Evropian. Qeveritë dhe qeverisjet shqiptare jo kurdoherë shkojnë pas njerëzve. Evropa lypset ta ndajë mirë këtë kontradiktë dhe ta mbështesë anën e popullit shqiptar. Evropa duhet t'i ndëshkojë qeveritë e qeverisjet joevropiane në Shqipëri dhe, njëkohësisht, ta shpërblejë popullin më proevropian në kontinent. Evropa kurrsesi nuk duhet t'i ndëshkojë shqiptarët për hir të qeverive dhe qeverisjes të këqija.

Bashkimi Evropian është krijuar për popujt e Evropës dhe është në përkushtim të tyre dhe nuk është krijuar për qeveritë evropiane dhe politikat e tyre. Populli shqiptar është brenda familjes evropiane dhe askush nuk mund ta ndajë prej saj. Ndërkohë që qeveritë shqiptare jo kurdoherë janë proevropiane dhe brenda parimeve qeverisëse të saj. Edhe në Evropë ka qeveri e politika që lajthisin duke u bërë euroskeptike, auoritariste, madje edhe anti-evropiane por, për hir të këtyre qeverive e politikave të lajthitura, Bashkimi Evropian nuk dënon popujt dhe nuk i privojnë ato nga familja evropiane.

A jemi ne, shqiptarët, të parët që nuk zgjedhim dot qeveritë dhe nuk përcaktojmë dot mënyrën tonë të qeverisjes së vendit?! A nuk gabuan gjermanët mbas demokracisë së Vajmarit?! A nuk u rrekën gabimisht francezët me qeverinë e Vishisë?! A nuk po përplasen agjenda qytetare me atë qeveritare në Britaninë e kohës së Brexitit?! A nuk ka politika populiste, nacionaliste, fobiste në shumë shtete të Evropës?! Po, edhe popuj më të mëdhenj, më të ditur, më të zhvilluar, më të pasur, më të fuqishëm se ne shqiptarët kanë gabuar e gabojnë në zgjedhjen e qeverive të tyre dhe në mënyrës së qeverisjes së vet. Por, ka qenë zgjuarsia e Bashkimit Evropian, e etërve themelues të tij, që kanë mbrojtur popujt dhe kanë ndëshkuar qeveritë, duke mbajtur kështu gjallë organizatën dhe mbarë unitetin e popujve të Evropës.

Epo, kur këto të vërteta dihen nga Evropa, përse nuk ndihmohet prej saj populli i vogël, i dobët dhe i varfër shqiptar që të zgjedhë më mirë qeveritë e tij dhe t'ua imponojë më mirë atyre mënyrën evropiane të qeverisjes?! Shqiptarët, anembanë Ballkanit presin nga Evropa, para së gjithash, të ndihmohen për zgjedhjen e qeverive të tyre dhe për t'ua imponuar atyre mënyrën evropiane të qeverisjes.

Të tjerat, ne, shqiptarët, i bëjmë vetë. Dimë të luftojmë në robëri e të punojmë në liri. Dimë të mësojmë buzë dritës e të hamë pranë sofrës. Dimë t'i respektojmë liritë e të lëmë pas mëritë. Dimë të gëzohemi si fëmijë e të mos hidhërohemi në pleqëri. Dimë të falim e jo të harrojmë, dimë për të kaluarën, por të ardhmen vështrojmë.

Prandaj, shqiptarë, me mendje të kthjellët e moral të pastër, me kokë lart e dinjitet njerëzor, të mos heqim dorë nga marshimi ynë drejt Evropës. Sepse, të jemi të sigurt që një ditë dielli do t'i shpërndajë fantazmat e errëta dhe të përgjakshme ballkanike dhe hienat e tyre të shtrira nëpër Evropë. Vetëm atëherë Evropa do të shohë se ndriçimi i saj vjen edhe nga fosfori i kockave dhe AND-ja e shqiptarëve, të derdhura në themelet e civilizimit të saj. Në atë moment të shumëpritur dhe të mirardhur, Evropa do të kuptojë se çdo mendim, qëndrim e veprim kundër shqiptarëve, është gërryerje e themeleve të saj. Dhëntë Zoti që ky moment të mos vonojë!

## Johnsoni beson se deputetët do ta miratojnë marrëveshjen për Brexitin

LONDËR, 18 TETOR - Kryeministri britanik, Boris Johnson, do të tentojë t'i bindë ligjvënësit për ta përkrahur marrëveshjen për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian në votimin që do të zhvillohet sot (e shtunë).
Johnsoni ka insistuar se "beson shumë" që ligjvënësit britanikë do ta përkrahin marrëveshjen e tij. Mirëpo deputetët opozitarë besojnë se ai do të përballet me pengesa teksa dërgon marrëveshjen në parlament.
Kryeministri britanik pritet të fokusohet te deputetët që kanë votuar në të mirë të Brexitit, por edhe te disa deputetë që janë larguar nga Partia Konservatore së cilës i përket Johnsoni.
Takimi i sotëm në parlament përbën mundësinë e fundit për Johnsonin që ta miratojë marrëveshjen për Brexitin dhe ta largojë Britaninë nga blloku evropian më 31 tetor.
Nëse deputetët refuzojnë planin e tij atëherë, bazuar në një ligj të miratuar nga vetë deputetët, Johnsoni detyrohet të kërkojë shtyrje të datës për Brexit deri më 31 janar të vitit 2020, pavarësisht pse ai ka insistuar se nuk do ta bëjë një gjë të tillë.
Teksa ka lavdëruar marrëveshjen e arritur në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian në Samitin e Liderëve Evropianë të enjten, kryeministri britanik u ka kërkuar të gjithë deputetëve të votojnë dhe ta finalizojnë procesin e Brexitit.
Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që e kanë kundërshtuar atë në referendumin e mbajtur më 2016.



# Kriza e fundit politike ndez gjakrat në Uashington

Presidenti Donald Trump po përpiqet t'i bllokojë përpjekjet e demokratëve për ta çuar përpara procesin për shkarkim, ndërkohë që është vënë në mbrojtje ndaj kritikave të shumta, madje edhe nga republikanë për vendimin e tij që t'i tërheqë trupat nga Siria




UASHINGTON, 18 TETOR - Uashingtoni zyrtar është fiksuar pas dy krizave të fundit politike: procesit për shkarkimin e mundshëm të presidentit dhe situatës në Siri. Presidenti Donald Trump po përpiqet t'i bllokojë përpjekjet e demokratëve për ta çuar përpara procesin për shkarkim, ndërkohë që është vënë në mbrojtje ndaj kritikave të shumta, madje edhe nga republikanë për vendimin e tij që t'i tërheqë trupat nga Siria, ka njoftuar voa.
Presidenti Trump komenton në Shtëpinë e Bardhë duke argumentuar vendimin për tërheqje nga Siria. "Ideja ishte që të qëndronim në atë vend vetëm 30 ditë. Kemi 10 vjet në atë vend. Është koha t'i kthejmë trupat në atdhe. Nuk jemi ne xhandar i botës, ka ardhur koha të kthehemi në atdhe", tha Trumpi.
Presidenti ka qenë i preokupuar këto ditë me procesin hetimor të hapur nga demokratët në Kongres që mund të çojë në shkarkimin e tij. Hetimet përqendrohen te kërkesa që presidenti i paraqiti homologut ukrainas për ta hetuar rivalin politik, Joe Biden. "Proces për shkarkim... Nuk ma merrte mendja që do ta dëgjoja këtë term në referencë ndaj meje. E thashë më parë: sa fjalë e shëmtuar. Për mua është fjalë e shëmtuar", tha ai.
Në këtë situatë hetimesh ishin ndezur gjakrat kur u zhvillua takimi i presidentit me ligjvënës demokratë në Shtëpinë e Bardhë lidhur me situatën në Siri. "Kam qenë ligjvënës gjatë mandateve të gjashtë presidentëve të ndryshëm. Kam marrë pjesë në shumë takime të tilla, por kurrë nuk kam parë një president që të sillet me kaq mungesë respekti ndaj një dege të barasvlershme të pushtetit në Shtetet e Bashkuara", tha ligjvënësi Steny Hoyer.
Duket se po shtohet presioni politik lidhur me procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit, thotë analisti John Fortier. "Pa diskutim ai po mendon skenarin e largimit nga detyra dhe reputacionin e tij më pas. Për sa i përket reagimit të Shtëpisë së Bardhë, mendoj se ka një metodë të ngjashme në reagim ndaj të gjitha krizave, duke rezistuar dhe duke u kundërpërgjigjur. Ata veprojnë me moton: çohu dhe kundërvepro. Këtë po shohim edhe tani", tha Fortier.
Të dyja palët në këto zhvillime po ndjekin me vëmendje opinionin publik, thotë analisti William Galston. "Republikanët duhet të tregohen shumë të kujdesshëm që të mos duken se po u dalin në mbrojtje veprimeve të pajustifikueshme. Nëse thonë se presidenti nuk ka bërë asgjë të gabuar ka gjasa të humbin pikë në sytë e publikut", tha ai.
Presidenti e ka prezantuar veten me krenari si një udhëheqës që i bën rezistencë traditës qeverisëse. Me avancimin e procesit hetimor pritet të shohim sjellje të tjera të pazakonta për një president, thotë historiania Barbara Ann Perry. "Deri tani ai i ka hedhur në erë të gjitha normat e praktikat pararendëse të 44 presidentëve të mëparshëm. Prandaj nuk do të çuditesha nga asgjë që bën ky president", tha ajo.
Pavarësisht nga rezultati i hetimeve që mund ta hapin procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit, gjasat janë që të thellohet polarizimi politik në vend. "Kjo betejë ka gjasa ta polarizojë edhe më shumë vendin. Do të shohim një vend shumë të përçarë, të ngjashëm me situatën që pamë më 1999 dhe 2000 pas procesit për shkarkimin e presidentit Clinton dhe gjatë polemikave që shoqëruan zgjedhjet presidenciale të vitit 2000", thotë Thomas Schartz, pedagog në Universitetin Vanderbilt.
Të gjitha këto kriza shpalosen në një kohë që vendi përgatitet për zgjedhjet e ardhshme presidenciale në nëntor 2020.

## Presidenti çek e akuzon Turqinë për krime lufte

PRAGË, 18 TETOR - Presidenti i Çekisë, Millosh Zeman, e akuzoi Turqinë për "bashkim me terroristët" në verilindje të Sirisë dhe për "kryerje të krimeve të luftës". "Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i quan kurdët terroristë, por unë nuk pajtohem", tha Zemani. "Përkundrazi, unë e pyes veten nëse ata që i sulmojnë kundër dhe kryejnë vrasje të neveritshme - si ajo e politikanes kurde - janë vetë terroristë", tha Zemani.
Ai iu referua vrasjes së politikanes kurde, Hevrin Khalaf, nga aleatët sirianë të Turqisë, gjatë një operacioni kundër milicive kurde.
Zeman, i njohur për pikëpamjet e tij pro-ruse dhe pro-kineze, po ashtu tha se Turqia po ndërton "lidhje të ngushta me islamizmin radikal dhe vrastar". "Unë mendoj se Turqia ka kryer krime lufte dhe në asnjë rast ajo nuk duhet të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian", tha Zemani.
Javën e kaluar Ushtria turke ka nisur një ofensivë kundër kurdëve në verilindje të Sirisë, për të pastruar, siç ka thënë, kufirin e saj nga terroristët.
Turqia i konsideron milicitë kurde në Siri si pjesë të Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit - grup ky që ka luftuar me dekada për autonominë kurde brenda Turqisë.
Ofensiva turke, e cila ka zgjatur tetë ditë, thuhet se ka lënë qindra njerëz të vrarë dhe të plagosur, ndërsa ka detyruar mijëra të tjerë të zhvendosen.
Të enjten mbrëma Turqia është pajtuar për një armëpushim të përkohshëm, pas disa orësh negociata me Shtetet e Bashkuara.




Shijo
Pranverën
me...
Jaffa
Champion
PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa
Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E jashtëzakonshme

## Zbulohen arkivolet e faraonëve të lashtë



Arkeologët zbuluan mbi 20 arkivole të drunjta në qytetin Luxor të enjten. Sipas Ministrisë së Antikitetit egjiptian, ato u gjetën afër rajonit të Thebanit në brigjet e Lumit Nil. Ishin dy shtresa me arkivole të mbivendosura sipër njëra-tjetrës, madje janë konsideruar prej zbulimeve më të rëndësishme sa i përket historisë dhe kulturës egjiptiane.

FOTO E DITES




Qindra kunguj shtrihen në një fushë afër Frankfurtit në Gjermani. /AP/

E rrallë

## Dy pensionistët krijojnë kopshtin magjik



Dy pensionistë kanë krijuar një kopsht tepër të veçantë, me ngjyra vjeshte, me rreth 16 mijë euro investim. Meri dhe Toni Njuton, të dy 71 vjeç, kanë punuar për 37 vjet për ta transformuar kopshtin para shtëpisë. Këtë vit e kanë bërë të ndizet me ngjyra vjeshte me 120 panja japoneze, 450 lule të ndryshme. Kopshti i tyre është shpallur më i bukuri në Britani dhe ka marrë emrin "Katër stinët", pasi pamja i qëndron tërheqëse gjatë gjithë vitit.

## BARSOLETA E DITËS



**Polici: Pse e vrave gruan?**
**Burri: Se më tradhtoi!**
**Polici: Po gruan e dytë?**
**Burri: Edhe ajo më tradhtoi!**
**Polici: Po të tretën?**
**Burri: Pastaj m'u bë shprehi!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton

Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D




Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning

Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP




Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
A keni qenë duke menduar për adoptimin e një kafshe? Nëse po, sot është dita ideale që të shkoni në qendër dhe të merrni një.



**DEMI**
Një person që doni mund t'ju japë frymëzim për një projekt krijues me të cilin po punoni.



**BINJAKËT**
Një ngjarje sociale që do ta mbani në shtëpinë tuaj mund t'ju frymëzojë që të bëni disa ndryshime në shtëpi.



**GAFORRJA**
Sot do t'ju vijë një mesazh i gjatë dhe i dashur nga një grua e cila ka gjasa të jetë nëna juaj.



**LUANI**
Sot mund t'ju vijë një shumë e vogël parash, ndoshta falë përpjekjeve të një gruaje.



VIRGJËRESHA
Energjitë e ditës së sotme do të sjellin sukses dhe të ardhura të mira.



**PESHORJA**
Sot do të keni shumë imagjinatë dhe do ta fusni në punë për të krijuar diçka të madhe, e cila do të shërbejë për t'i rritur interesat tuaja në biznes.



**AKREPI**
Mos u surprizoni nëse ndieni tërheqje të madhe për një person që e keni takuar në punë.



**SHIGJETARI**
Sot do të kuptoni se keni një ndjenjë të fuqishme dashurie për dikë që jeton larg.



BRICJAPI
Dashuria dhe pasioni mund të jenë në mendjen tuaj.



**UJORI**
Nëse jeni beqarë, ju mund të takoni dikë që ju ka pëlqyer prej kohësh, por nuk ia keni shprehur.



PESHQIT
Sot do të keni shumë imagjinatë dhe do ta fusni në punë për të krijuar diçka të madhe, e cila do të shërbejë për t'i rritur interesat tuaja në biznes.

# Kate Middleton, zbathur dhe me veshje tradicionale teksa viziton një xhami në Pakistan



Edhe këtë herë Kate Middleton ka qenë e përkryer. Me një pamje siç e do tradita, me shami dhe veshje tradicionale dhe një elegancë natyrale, dukesha e Cambridges i ka magjepsur të gjithë teksa është shfaqur zbathur në një xhami në Pakistan, ku ajo ndodhet së bashku me bashkëshortin për një vizitë zyrtare. Për të hyrë në xhaminë Badshahi së bashku me Williamin ajo është ftuar t'i heqë këpucët, duke shfaqur çorapët ngjyrë mishi, ku dukeshin këmbët e kuruara dhe një manikyr i kuq.

# Ja pse çifti i famshëm i telenovelave nuk dëshiron të martohet



Që nga "Teresa", seriali i famshëm ku Sebastian Rulli dhe Angelique Boyer ishin protagonistë, dyshja ishte e destinuar për të mos u ndarë më. Prej vitesh, dy aktorët e famshëm jetojnë një histori të bukur dashurie por, për martesë, as nuk kanë ndër mend. Sipas mediave spanjolle, së fundi Rulli është vënë në shënjestër të lajmeve rozë sepse nuk po zbulohej arsyeja pse ai dhe partnerja e tij po qëndrojnë kaq larg altarit. Siç mësohet të ketë thënë vetë aktori, ai nuk beson shumë te martesa, por beson te dashuria dhe lidhja e fortë që ai dhe Angelique kanë për njëri-tjetrin. Sipas Rullit, martesa nuk e bën një çift më të përgjegjshëm, pro dashuria.



# Cardi B dhe Offset, 'të çmendur' në Karaibe

Cardi B dhe Offset janë, ndoshta, çifti më "i çmendur" i reperëve që mund të keni parë ndonjëherë. Dyshja, tepër e dashuruar, duket se e ka shijuar në maksimum udhëtimin e fundit për në "Turks & Caicos" në Karaibe. Këtë e vërtetojnë fotografitë e nxehta që ka publikuar Cardi B në "Instagram", mbi një motor uji me bashkëshortin.

# Jessie J në rrugët e Los Anxhelosit




Ajo është e njohur për sensin e saj të çuditshëm të stilit. Dhe Jessie J zgjodhi një tjetër veshje elegante dhe eksentrike, derisa ajo vizitoi një sallon në Los Anxhelos me një mike. Këngëtarja "Bang Bang", 31-vjeçare, goditi me pamje të rastësishme në një bluzë të bardhë me mëngë të shkurtra, nga Vetements dhe xhinse. Pamja e Jessie J ishte e spërkatur nga një palë çizme lëkure të bardha të ngushta me kyçin e këmbës dhe llak jeshil i thonjve.

BISEDË ME ZONJËN NURIJE AVDIU, DREJTORESHË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT NË KOMUNËN E FUSHË-KOSOVËS

# Sa herë i kujtoj Xhevë dhe Fehmi Ll



**Prishtinë, 18 tetor**- Nurije Avdiu që nga viti 2001 është drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Fushë-Kosovës. Sapo pati përfunduar lufta në Kosovë, së bashku me bashkëshortin, i cili kishte miqësi me Xhevë dhe Fehmi Lladrovcin, erdhën në Kosovën e shkatërruar fund e krye. Detyra e parë udhëheqëse në Kosovë, pas ardhjes nga Kroacia, iu dha në Malishevë, në drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Pasi realizoi disa punë atje dhe i qiti në vend, erdhi në vendlindjen e vet në Fushë-Kosovë dhe në këtë komunë mori detyrën e drejtoreshë së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nisi të hapë biblioteka e të organizojë aktivitete kulturore, rinore dhe sportive, të cilat i rrëfen në këtë bashkëbisedim, njëkohësisht kujton ditët e takimit me heronjtë Xhevë dhe Fehmi Lladrovci në Zagreb, të cilëve ua kishte qëndisur emblemat e UÇK-së për uniformë

**Zonja Nurije, ku dhe kur i filluat aktivitetet e para kulturore?**

Aktivitetet e para i kam filluar kur kam qenë nxënëse në shkollën fillore. Aty jam angazhuar në grupe të vallëzimit si dhe në grupin e recituesve. Disa herë edhe jam shpërblyer me çmime për paraqitje. Aktivitetin e tillë e kam vazhduar edhe në shkollë të mesme, pastaj në universitet si anëtare e Shoqërisë së Studentëve "Ramiz Sadiku", pastaj ShKA "Bajram Curri" etj. Kam qenë e angazhuar edhe në grupin dramatik si aktore. Kam luajtur disa role në teatrin e qytetit të Prishtinës disa vjet me radhë, kurse dashuria dhe përkushtimi për kulturë ishte dhe është vokacioni im shpirtëror. Mendoj se kultura është ambasadorja më e mirë e një kombi. Prandaj, vazhdoj të punoj me përkushtim për kulturën dhe aktivitetet kulturore.

**Keni dhënë kontribut edhe në themelimin e shkollës së parë shqipe me mësim plotësues në Kroaci. Mund të na flisni për atë kohë?**

Në Kroaci (Zagreb) kam jetuar para dhe pas luftës së Kosovës. Jeta kulturore e studentëve atje ishte pak a shumë e organizuar. Angazhimi dhe aktivizimi i disa intelektualëve shqiptarë që jetojnë me vite në Zagreb bëri që të ndryshojë shumë jeta kulturore, por edhe sportive e të gjithë studentëve. E ndieja për obligim moral dhe atdhetar që së bashku me disa intelektualë shqiptarë që jetonin dhe vepronin në Kroaci t'u ndihmonin e t'i përkrahnin studentët shqiptarë, posaçërisht për aktivizimin e fuqishëm të Shoqatës së Studentëve "Shkëndija". Disa vjet me radhë kam qenë anëtare e kryesisë së kësaj shoqate, më pastaj anëtare e kryesisë e Bashkësisë Shqiptare të Zagrebit. Me disa intelektualë shqiptarë formuam grupin iniciues për themelimin e dy institucioneve të rëndësishme për shqiptarët e Kroacisë, si: hapjen e shkollës shqipe (mësim plotësues) dhe bibliotekën shqipe të cilat u themeluan me shumë mund e përpjekje. Ato edhe sot e kësaj dite funksionojnë. Edhe sot e kujtoj me shumë nostalgji fillimin e funksionimit të shkollës shqipe. Në fillim ishte një numër i konsiderueshëm nxënësish, të cilët u shpëtuan nga humbja e identitetit të tyre, në veçanti fëmijët që vinin nga familjet e përziera. Unë isha mësuese dhe udhëheqëse e shkollës. Mësimi mbahej në lokalet e shkollës "Izidor Krshnjavi", e cila ishte shkolla më e vjetër në Zagreb. Interesimi i nxënësve ishte për të mësuar e për të nxënë dije ishte i jashtëzakonshëm. Unë dhe kolegët e mi për vite të tëra punuam në atë tempull dije pa ndonjë përfitim financiar, sidomos në fundjavë vikendet, në mënyrë që nxënësit të mësonin e të mos e humbnin gjuhën e të parëve, gjuhën shqipe. E them shumë sinqerisht, se edhe tani kur po e bëjmë këtë bisedë, ndiej emocione të veçanta, por edhe një lloj krenarie e lumturie përbrenda qenies sime, kur rezultatet e punës dhe mundit të asaj kohe janë shpërblyer. A ka kënaqësi më të madhe sesa t'i shohësh se sa kanë mbërritur në dije e shkollim nxënësit që i ke edukuar dhe mësuar. Shumë prej tyre sot jetojnë dhe veprojnë në Kosovë dhe flasin gjuhën shqipe. Një pjesë e tyre janë të angazhuar në institucionet më të larta shtetërore të Kosovës, si: në Gjykatën Kushtetuese, në Kuvendin e Kosovës, Presidencë dhe Qeveri. Gjithashtu, disa prej tyre janë angazhuar në arsim, shëndetësi, kulturë, biznes e fusha të ndryshme të jetës e të kulturës. I kam shumë të freskëta këto kujtime pune dhe angazhimi atje: bibliotekën e themeluam me libra të dhuruara nga qytetarët shqiptarë nga bibliotekat e tyre familjare si dhe me ndihmën e Ambasadës Shqiptare që gjendej në Zagreb. Dikur filloi punën me kapacitet të vogël, kurse sot punon me kapacitet të plotë.

## Sa herë i kujtoj Xhevë dhe Fehmi Lladrovcin më mbushen sytë me lot

**Zonja Nurije, ju keni punuar edhe uniformat e para të dy dëshmorëve të kombit, bashkëshortëve Xhevë dhe Fehmi Lladrovci. Mund të na shpalosni disa prej çasteve kur ata i veshën uniformat dhe u nisën për luftë në Kosovë?**

Oh... Sa herë që më kujtohen më mbushen sytë me lot. Fehmiun dhe Xhevën (tani dëshmorë të kombit) i kishim miq shtëpie. Fehmiu me bashkëshortin tim ishin shokë të studimeve nga Zagrebi. Ishin shokë të pandarë. Xheva ma mori zemrën si një femër intelektuale dhe grua e fuqishme. Para se të fillojë lufta në Kosovë, ata flisnin vetëm për luftën dhe mllefin që kishin kundër Serbisë. Ata vendosën t'ia mësyjnë luftës kroate-serbe. U pajisën me uniforma dhe me dorën time ua kam qëndisur dy emblema, pastaj të gjitha uniformat e luftëtarëve të parë shqiptarë në këtë luftë të tmerrshme ashtu siç m'i kërkonte Fehmiu. Pas përfundimit të luftës kroate-serbe, që la pasoja të mëdha me të vdekur e të plagosur nga Brigada Shqiptare, Fehmiu dhe Xheva

# adrovcin më mbushen sytë me lot



vazhduan rrugëtimin e tyre për të mos u kthyer më në Kroaci. E kam shumë vështirë të flas e ta shpreh dhimbjen që ndiej për humbjen e dy miqve të mi prej të cilëve mësova shumë. Kam shumë emocione në këto çaste që i kujtoj.

### Malisheva dhe malishevasit më mahnitën me mikpritjen

Pas mbarimit të luftës jeni kthyer në Kosovë. Sërish i jeni përkushtuar kulturës, duke drejtuar Drejtorinë e Kulturës në Malishevë, komunë kjo që u shkatërrua në luftë. Cilat ishin prioritetet tuaja që ta ringjallni jetën kulturore në këtë komunë?
Bashkëshorti im ishte pjesëtar i UÇK-së. Pas mbarimit të luftës në Kosovë ai nuk u kthye më atje ku jetoi, studioi e veproi, në Zagreb. Unë isha e vetme atje ku punoja për ta mbajtur gjallë veten dhe familjen. Pas përfundimit të luftës vendosëm të kthehemi të dytë në Kosovë. Nga lufta ishte shkatërruar gjithçka në Kosovë. Edhe qytetin e Malishevës e gjeta të shkatërruar në shtator të vitit 1999. Ato ditë vetëm sa filloi të funksionojë komuna. U punësova aty me dëshirë dhe vullnet, që të kontribuoj bashkë me kolegët që gjeta aty për ngritjen e vetëdijes dhe rehabilitimit të tyre nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore, të cilat i kishte ndërprerë lufta dhe katrahuara që kishte kapluar këtë komunë. Isha e lumtur që arrita të pranohem në një rreth të panjohur për mua, por me një kulturë të shkëlqyeshme të qytetarëve e me një mikpritje të përzemërt e cila ishte traditë e kësaj komune.

Gjatë punës sime që kam bërë atje krenohem edhe sot jo vetëm për aktivitetet kulturore dhe sportive, por edhe për krijimin e institucioneve të reja të kulturës, për hapjen e bibliotekës së qytetit dhe pë1r pasurimin e saj me fond librar. Gjithmonë i kam pasur për zemër gjurmimet arkeologjike. Aty në mes të Malishevës ndodhej tuma ilire, por nën mëshirën e natyrës. Ishte ideja ime që kjo tumë ilire të futej nën mbrojtje, e që sot e kësaj dite është thesar i çmuar për Malishevën. Organizuam edhe koncerte, shënime datash dhe përvjetorësh të personaliteteve letrare dhe atdhetare, hapëm konkurse letrare dhe dhamë çmime, riaktivizuan ShKA "Rifat Beirsha" etj.

**Pastaj, pas një kohe të punës në Malishevë, kontributin e zhvendosët në qytetin e Fushë-Kosovës. Sot drejtoni Drejtorinë për Kulturë në Fushë-Kosovë.**
Unë jam nga Fushë Kosova, dhe ëndërr e imja ka qenë gjithmonë të kontribuoj për qytetin tim, këtu ku u rrita dhe u shkollova. Në Fushë-Kosovë kam filluar të punoj në maj të vitit 2001. Po të njëjtën gjendje siç e gjeta Malishevën, e gjeta edhe në këtë qytet, i shkatërruar tërësisht nga lufta e fundit. Pasojat ishin aq të mëdha në njerëz dhe në infrastrukturë. Jeta kulturore thuajse nuk funksiononte. Me marrjen në menaxhim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ia dhashë detyrë vetvetes të punoj dhe ta jap maksimumin në punë. Në radhë të parë, krijimi i institucioneve kulturore dhe sportive ishte parësor. Iniciova themelimin e bibliotekave në qytetin e Fushë-Kosovës dhe ndarjen e saj në sektorë, pastaj rehabilitimin e bibliotekës në Sllatinë të Madhe, në Bardh të Madh filluam ndërtimin e objektit të bibliotekës, ndërkohë pasurimin me inventarë dhe literaturë për të gjitha bibliotekat. Themeluam Arkivin e Qytetit, Muzeun e Fushë- Kosovës. Themeluam Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "Zëri i Kosovës", Teatrin "Qëndresa" dhe aktivizuam Festivalin e Teatrove. Në bashkëpunim me institucionet e larta të kulturës së Kosovës filluam edhe zbulimet arkeologjike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, ku hasëm në shumë pika arkeologjike, siç janë të njohura tanimë jo vetën në Kosovë, por edhe jashtë, si: Kalaja e Bardhit të Madh, Varrezat Dardane në Graboc Kalaja e Harilaqit të cilat janë krenaria e kulturës së Fushë-Kosovës. Po ashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Muzeun e Kosovës, Institutin Arkeologjik të Kosovës kemi zhvilluar projekte të përbashkëta në arkeologji dhe kanë rezultuar të suksesshme, duke e shndërruar Kalanë e Harilaqit ndër pikat më atraktive për vizitorë nga vendorë dhe të huaj. Që nga viti 2001, prej që udhëheq Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë themeluar mbi 22 klube sportive të cilat kanë rezultate kulmore në të gjitha arenat sportive brenda dhe jashtë Kosovës. Janë realizuar mbi dhjetëra salla sportive dhe turne në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Qindra projekte kulturore, festivale, koncerte dhe manifestime të ndryshme janë realizuar nën përkujdesjen time dhe të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Festivali Ballkanik i Folklorit ishte ide e imja të cilën arrita ta finalizoj vitin e kaluar, e që pati sukses të jashtëzakonshëm. Së këndejmi, jua kujtoj se Komuna e Fushë-Kosovës tashmë është e njohur për aktivitete kulturor edhe në arenën ndërkombëtare, duke marrë pjesë në shumë festivale të ndryshme, në të cilët kemi prezantuar kulturën shqiptare, edhe kemi marrë çmime dhe mirënjohje të ndryshme.

**Kolegët ju quajnë njeri human. E keni të trashëguar?**
Humanizmi im rrjedh nga kultura dhe tradita familjare. Babai im ishte njeri human. Shtëpia e tij para luftës, në kohën kur në Kosovë u mbyllën të gjitha institucionet shkollore nga regjimi i atëhershëm, ishte shkollë shtëpi. Shtëpia jonë u bë mësonjëtore e qindra nxënësve.

### Ardhmëria e këtij vendi janë të rinjtë

**Sa i ndihmoni të rinjtë për realizim të projekteve?**
Shumë. Sepse ardhmëria e këtij vendi janë të rinjtë. Jam përpjekur dhe po përpiqem që të rinjtë t'i angazhojmë në institucione, në klube sportive, në ansamble kulturore. Duke ua dhënë këtë mundësi të pjesëmarrjes ilargojmë nga bredhja rrugëve dhe nga dukuritë negative. Sot shumë të rinj i kemi të aktivizuar në festivale dhe punëtori të piktures, filmit, muzikës e në kurse të ndryshme.

**Sa vështirë e keni pasur të udhëhiqni kaq gjatë një drejtori me disa fushëveprimtari?**
Kam qenë e vetmja femër drejtoreshë në Komunën e Fushë-Kosovës që nga viti 2001. Po të mos e kisha përkrahjen e kolegëve të mi s'do të kisha pasur mundësi të qëndroja në këmbë.

*(Bisedoi: Ajete Zogaj)*

---

KA PËRFUNDUAR AKTIVITETI I KARVANIT TË SHKRIMTARËVE PËR FËMIJË "AGIM DEVA"

# Veli Veliut iu dha çmimi i parë letrar 'Ymer Elshani'



PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Në sallën e Institutit Albanologjik, në javën e kaluar, në praninë e shkrimtarëve për fëmijë, është shënuar përfundimi i sezonit të 20 të manifestimit letrar Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë "Agim Deva" në Prishtinë. Për veprimtarinë e këtij manifestimi tradicional të zhvilluar gjatë këtij viti foli Xhevat Syla, drejtor i Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë.
Veprat më të reja, në gjini të ndryshme letrare, pasi i ka lexuar juria profesionale, në përbërje Ibrahim Kadriu, Xhevat Syla dhe Ramadan Musliu, si më të mirën botuar midis dy manifestimeve, ka zgjedhur romanin Pallati i tregtarit në kryeqytet të autorit Veli Veliu të cilit i ka dhënë Çmimin e parë "Ymer Elshani", kurse veprën e dytë ka zgjedhur vëllimin me poezi "Rrak e tak" të poetit Gjon Gjergjaj.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisim Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# FFK-ja: S'ka bileta në shitje për ndeshjen me Çekinë

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) nëpërmjet një njoftimi ka bërë me dije se nuk do të ketë në shitje bileta për ndeshjen Çeki - Kosovë që zhvillohet në Plezen.
FFK-ja ka njoftuar se sasia e biletave që ka në dispozicion është shumë e vogël dhe ato do t'u shpërndahen dardanëve, institucioneve, partnerëve të FFK-së dhe familjarëve të futbollistëve. "Duke kuptuar interesimin e jashtëzakonshëm të publikut dhe tifozëve për ta mbështetur Kombëtaren e Kosovës në sfidën më të rëndësishme deri tani, atë kundër Republikës Çeke, Federata e Futbollit e Kosovës me keqardhje të thellë është e detyruar t'u bëjë thirrje tifozëve që të mos bëjnë rezervime për fluturime dhe hotele për shkak të numrit jashtëzakonisht të vogël të biletave që FFK-ja ka në dispozicion për këtë ndeshje. Në bazë të nevojave, biletat që janë në dispozicionin tonë do t'i jepen grupit të tifozëve 'Dardanët', kurse pastaj, në bazë të obligimeve kontraktuale që ka, FFK-ja do të ndaj bileta për sponsorët, bashkëpunëtorët, institucionet si dhe në fund, për familjarët e futbollistëve", është theksuar në njoftimin e FFK-së.




FFK-ja ka theksuar se çmojnë jashtëzakonisht shumë përkrahjen e parezervë që merr nga publiku për rrugëtimin drejt kualifikimit. "U jemi shumë mirënjohës të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mërgimtarëve që janë në gjendje të bëjnë shpenzime të pabesueshme vetëm për të qenë krah futbollistëve në këtë ndeshje, por në situatën në të cilën jemi, e kemi të pamundur të sigurojmë bileta për takimin që zhvillohet në Plzen. Stadiumi ku zhvillohet ndeshja ka kapacitet të ulët dhe, përkundër insistimit tonë, Federata Çeke e Futbollit ka refuzuar të ndaj numër pak më të madh të biletave për sektorin e shikuesve mysafirë", është thënë në njoftimin e FFK-së.

# Milot Rashica: Iu gëzohem fitoreve të Shqipërisë dhe të Kosovës

PRISHTINË, 18 TETOR - Milot Rashica po kalon një çast fantastik në kampionatin gjerman, duke shënuar thuajse në çdo ndeshje me Shalke 04 në Bundesligë.
Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë që aktivizohet tashmë me Kosovën ka dhënë një intervistë për "RTSH Sport", në të cilën ka folur për ndeshjet e dy skuadrave përfaqësuese, duke shtuar se u gëzohet fitoreve të të dyja skuadrave. "Rritja e Kosovës? Duke parë grupin që kemi, nga kualifikimet e para kemi parë që ka diçka të mirë. Jemi rritur shumë dhe kemi bërë përparim shumë të madh. Për momentin po shkojmë mirë dhe jam mirë me klubin. Fituam një ndeshje, por kemi një finale në Çeki dhe shpresoj ta fitojmë", është shprehur Rashica.



Ai u pyet edhe për Shqipërinë. "E kam ndjekur ndeshjen e fundit dhe kanë luajtur mirë. U uroj më të mirat dhe shpresoj të kualifikohen. Jam kthyer në vendin ku kam lindur dhe rritur. Iu gëzohem fitoreve të të dyja skuadrave, të Kosovës e të Shqipërisë", ka theksuar Rashica.




# Hetimet për shitjen e biletave online, reagon UEFA

PRISHTINË, 18 TETOR - Të premten ka reaguar edhe UEFA rreth shitjes së biletave për ndeshjet e Kosovës të cilët i luan në cilësinë e vendësit. Shumë qytetarë dhe dashamirës të futbollit janë ankuar për mënyrën e shitjes së këtyre biletave nëpërmjet sistemit online "tiks.app".
Ditë më parë edhe Prokuroria e Shtetit të Kosovës ka nisur hetimet rreth kësaj çështje. Ndërkohë të enjten sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, në një prononcim për "KosovaPress" ka thënë se kjo iniciativë e Prokurorisë së Shtetit mund të cilësohet si ndërhyrje në punën e Federatës së Futbollit dhe se kanë biseduar edhe me UEFA-n e FIFA-n për këtë çështje. Mirëpo një gjë e tillë është mohuar nga UEFA, të cilët në përgjigjen e pyetjeve të drejtuara nga redaksia e sportit të "KosovaPress"-it kanë thënë se nuk kanë ndonjë informatë rreth kësaj çështje. "Nuk kemi ndonjë informatë lidhur me këtë rast", thuhej në këtë përgjigje.

# Hapet procesi i akreditimit për ndeshjet e nëntorit

PRISHTINË, 18 TETOR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar përfaqësuesit e medieve se është hapur procesi i akreditimit për ndeshjet Çeki - Kosovë (European Qualifiers) e cila do të zhvillohet më 14 nëntor 2019 në orën 20:45, në stadiumin "Doosan Arena", në Plzen të Çekisë. Afati i fundit për aplikim është 4 nëntor.
Ndërkaq ndeshja Kosovë - Angli (European Qualifiers) do të zhvillohet më 17 nëntor 2019, në orën 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Afati i fundit për aplikim është 8 nëntor 2019. Kërkesat e pranuara pas




këtij afati do të merren në shqyrtim varësisht prej vendeve të lira në dispozicion.

## KF Drenica thotë se nuk ua ka borxh lojtarëve dy paga

PRISHTINË, 18 TETOR - Në media është raportuar se te Klubi i Futbollit Drenica ka probleme financiare. Madje u raportua se Drenica u ka borxh dy pagat e fundit lojtarëve dhe kështu kanë filluar pakënaqësitë e lojtarëve. Pas këtij lajmi ka reaguar Klubi i Futbollit Drenica. "Ju njoftojmë se KF Drenica ka vonesë të pagave vetëm për muajin e fundit dhe për dhjetë ditë janë vonuar pagat e muajit të fundit. Drejtuesit e klubit janë në përgatitje e sipër për ta paguar edhe pagën e fundit. Kjo është e gjithë e vërteta e cila mund të konfirmohet edhe përmes futbollistëve dhe stafit të KF Drenica, por edhe dëshmive bankare", është thënë në reagimin e këtij klubi të futbollit.

KF. - FC. DRENICA SKËNDERAJ 1958

